



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 25.02.2025

Nr: 191

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË DENONCIMIN NR. 45 ID, DATË 21.02.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE, TË PARTIA DEMOKRATIKE

Sot më datë 25.02.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

KËRKUES: Partia Demokratike

SUBJEKT: **Zj. Valbona Kola**
Kryetar i Bashkisë Klos

Zj. Hazbie Dedolli
Kryetar i Këshillit Bashkiak, Klos

Z. Etmond Demiri
Sekretar i Këshillit Bashkiak, Klos

OBJEKT: Konstatimi i kryerjes së veprimtarive të ndaluara, nga neni 91/4, i Kodit Zgjedhor dhe vendimi nr. 9/2020, i Komisionit Rregullator, konkretisht nxjerrja e akteve para fushatës zgjedhore që synojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë dhe përdorimi i burimeve publike

BAZA LIGJORE: Neni 91, pikat 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n”, dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator

KONSTATOJ:

Partia Demokratike më datë 21.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 45 ID.

Data: 25.02.2025

Nr: 191
Ora: 12:00



“Për fillimin e procedurës administrative bazuar në denoncimin nr. 45 ID datë 21.02.2025, të regjistrin të denoncimeve, të Partia Demokratike”

Në këtë denoncim Partia Demokratike parashtron sa vijon:

“Partia Demokratike ka marrë dijeni se Bashkia Klos, më datë 28 Janar 2025 ka mbajtur mbledhjen e Këshillit të Bashkisë, thirrur nga Kryetarja e Bashkisë zj. Valbona Kola, me rend dite ndër të tjera:

- *Pika 3, e rendit të ditës “Shqyrtim dhe miratim projekt-vendim për ‘Miratimin e listës së familjeve të pastreha në Bashkinë Klos, për efekt subvencionim qiraje për vitin 2025 me të ardhurat mesatare vjetore’;*
- *Pika 4, e rendit të ditës ‘Shqyrtim dhe miratim projekt-vendim për ‘Miratimin e listës së familjeve në nevojë që përfitojnë nga programi i strehimit social-Përmirësimi i kushteve të banesave ekzistuese deri në një ndërtim të ri.’*

Nga sa më sipër çmtoj se, ekzistojnë kushtet për t’u nisur hetimi administrativ.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

V E N D O S:

1. Fillimin e procedurës administrative ndaj:
 - Zj. Valbona Kola, Kryetar i Bashkisë Klos;
 - Zj. Hazbie Dedolli, Kryetar i Këshillit Bashkiak, Klos;
 - Z. Etmond Demiri, Sekretar i Këshillit Bashkiak, Klos.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

